REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1086/20
Datë/Datum. 22.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***15.12.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***22.12.2020***	***Nr. i lëndës:*** ***1086/20***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.12.2020, OE "AWA sh.p.k "-Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **1086/20,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "Mebli Dizajn"shpk - Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me rekuizita sportive për shkolla",** me nr.të prokurimit: 623-20-6056-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Rahovecit .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, kontrate publike kornizë me një operator, vlera parashikuar e kontratës: 19,061.00 €.

Data e njoftimit për kontratë 06.10.2020, data e hapjes së ofertës 16.10.2020, njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues 25.11.2020, kërkesa për rishqyrtim 30.11.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, sic janë
Neni 1, 6,7, 59,60, dhe 68, të LPP-së, si dhe nenin 41 UOPP-së.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

AK/komisioni vlerësues gjate vlerësimit te ofertave për tenderin ne fjale nuk ka vepruar ne harmoni me LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore te lartcekura dhe udhëzimin operativ për prokurim publik.

Me 25.11. kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK dhe letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, kompania jone është eliminuar me arsyejen se nuk kemi plotësuar kërkesën ne FDT lidhur me kapacitetin ekonomik&financiar përkatësisht raporti i bankës i dorëzuar nuk plotëson minimumin e kërkuar prej 38,000.00euro.

Kjo nuk qëndron, dëshmi bankare te dorëzuara për ketë projekt kemi paraqitu qarkullimin bankar te realizuar ne bankën pro credit bank për periudhën 09.09.2019- 16.10.2020. e cila arrin vlerën totale 44,500.70

Përderisa kemi plotësuar dëshmitë lidhur me kapacitetin ekonomik&financiar me raportin e një institucioni financiar, nuk e kemi pa te arsyeshme te dorëzojmë raportet nga bankat tjera.

Bashkangjitur me kërkese për ri-shqyrtim serish i kemi dërguar AK- KK Rahovec qarkullimin bankar te lëshuar nga pro credit bank për periudhën 09.09.2019-16.10.2020.

AK /Zyra e prokurimit ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim duke u mbështetur ne nenin 41.7 te UOPP-se pasi qe sipas tyre tjetër dokument (qarkullim bankar) kemi paraqitur ne oferte ndërsa tjetër dëshmi kemi dërguar bashkangjitur me kërkesën për ri-shqyrtim.

Kjo nuk qëndron, është fjala për te njëjtën banke, te njëjtën periudhe dhe dëshmia identike e dorëzuar me oferte. Qarkullimi i dërguar me kërkesë për ri-shqyrtim është dëshmia e nxjerrë nga e-banking sa për vërtetim tek AK se plotësojmë kërkesën lidhur me kapacitetin ekonomik&financiar dhe është identike me dëshminë e dorëzuar ditën e ofertimit te cilën kemi nënshkruar vulosur ne degën e bankës.

Edhe sikur te mos kishim dorëzuar dëshminë e qarkullimit bankar AK para se te vendos për eliminimin e kompanisë sonë është dashur te kërkojnë sqarime shtese konform nenit 72.3 te LPP-se dhe nenit 39 te UOPP-se duke u bazuar ne faktin se ekzistenca e dokumentit mund te verifikohet ne mënyrë objektive se është para datës se dorëzimit te ofertave.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

M.3

		Kërkesat e përshtatshmërisë: **Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbipërshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi ProkuriminPublik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publiktë Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dheligjin Nr. 05 L-092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Deklarata nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes).**
		Kërkesa 2 Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK.	**Dëshmia 2 Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne ëeb faqen e ATK-se).**
		Kërkesa 3 Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dorëzimit të ofertës.	**Dëshmia 3 Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar nga noteri).**
			• Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2, 3, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj si të papërgjegjshme dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale** **Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin professional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje.**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar** **Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, ka qenë në vlerë jo më pak se 38,000.00 Euro**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë.**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy (2) kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e Furnizimeve te kryera në lëmin e furnizimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Furnizimet e kryera, shumën e kontratës, vendit, datën si dhe Nr. e Prokurimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, e përcjellur me Kopje të Referencës ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues, ka konstatuar si në vijim: AK- Komuna e Rahovecit shpërblen me kontratë OE "Mebli Dizajn"shpk –Rahovec, në vlerë totale prej 14,687.90 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Komuna e Rahovecit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i

MB

kontratës furnizim, Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër eliminimit të OE ankues.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "AWA sh.p.k "-Prishtinë

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AWA sh.p.k "-Prishtinë se AK e ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin " se nuk kemi plotësuar kërkesën ne FDT lidhur me kapacitetin ekonomik&financiar përkatësisht raporti i bankës i dorëzuar nuk plotëson minimumin e kërkuar prej 38,000.00euro". Tutje, OE ankues shton se nuk qëndron, arsyetimi i AK ku si dëshmi bankare te dorëzuara për ketë projekt kemi paraqitu qarkullimin bankar te realizuar ne bankën pro credit bank për periudhën 09.09.2019- 16.10.2020. e cila arrin vlerën totale 44,500.70 euro. OE ankues në kërkesën për ri-shqyrtim serish i ka dërguar AK- KK Rahovec, qarkullimin bankar te lëshuar nga pro credit bank për periudhën 09.09.2019-16.10.2020. Mirpo, AK ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim me arsyetimin se dokument (qarkullim bankar) tjetër keni paraqitur ne oferte ndërsa tjetër dëshmi kemi dërguar bashkangjitur me kërkesën për ri-shqyrtim.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar 8.1 & 8.2 ka kërkuar:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar **Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, ka qenë në vlerë jo më pak se 38,000.00 Euro**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë.**

OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka dorëzuar dokumentin me titull "qarkullimi financiar", dokument i cili është nxjerr në bankën Pro Credit me datë 16.10.2020 në ora 01:24:10 për periudhën 09.09.2019-05.09.2020. Sipas këtij dokumenti, OE ankues nuk e plotëson kriterin e kërkuar në pikën 8.1&8.2, ku është kërkuar qarkullim në vlerë jo më pak se 38,000.00 euro dhe vlera e përcaktuar nga AK është e saktë sepse sipas dokumentit të OE ankues shuma e qarkullimit është më pak se 38,000.00 euro.

Ndersa, sa i perket arsyes se AK-se, se dokument (qarkullim bankar) tjetër është paraqitur në oferte ndërsa tjetër dëshmi ka bashkangjitur me kërkesën për ri-shqyrtim OE ankues.

Në kërkesën për ri shqyrtim pranë AK-së dhe ankesën e parashtruar në OSHP, OE ankues ka bashkangjitur një dokument tjetër të lëshuar nga banka Pro Credit Bank me të njëjtën llogari bankare dhe për periudhën 09.09.2019 deri me 10.10.2020, ku data e lëshimit të këtij dokumenti është 28.11.2020 në ora 1:56:42 PM. Deshmia, pra gjendja siq ka potencar edhe ankuesi është po e njeja mirpo vetem vezioni ndryshon gjeresa

periudha është po e njejta, pra gjendja e bashkangitur në oferte është ne verzionin E-banking e qe eshte valide sepse ka vulen dhe daten e printimit ndërsa deshmia e deklaruar me daten 16.10.2020 është e printuar nga zyrtari i bankes, andaj si e tille gjendet e bazuar.

Sipas këtij dokumenti, OE ankues e plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 8.1&8.2 të dosjes së tenderit pasi që kalon vlerën e qarkullimit mbi 38,000.00 euro.

Andaj, meqenëse ekstrakti bankar i dorëzuar në kërkesën për ri shqyrtim tejkalon shumën mbi 38,000.00 euro sipas kërkesës së AK-së, si dhe është për periudhën para datës së njoftimit për kontratë, për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk paraqet ndryshim material sepse qarkullimi apo transaskionet në shumë mbi 38,000.00 euro janë para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pra, Autoritetit Kontraktues me qëllim të arritjes së ekonomicitetit dhe efikasitetit sipas nenit 6 të LPP-së, si dhe në shërbim të nenit 1 të LPP-së, për mendimin e ekspertit shqyrtues është dashur që në kërkesën për ri-shqyrtim ta merr për bazë këtë dokument sepse sipas ekstraktit bankar (pasqyrës së llogarisë) të gjitha transaksionet janë para publikimit të njoftimit për kontratë. Konform nenit 72 te LPP-së, mendoj se ky aktivitet i prokurimit duhet te kthehet ne rivlersim, AK mund te kerkoj informata shtese nga ankuesi gjegjesishte te kerkoj gjendjen bakare/qarkullimin bankar me saktesishte për tender pra me nje verzion tjeter, por pa ndryshuar gjendjen materiale, me fjale të tjera AK mund ta analizoj shumen e qarkullimi duke krahasuar gjendjet.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këte raport, Eksperti shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të anulohet dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Rahovecit .

M.B

- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "AWA sh.p.k "-Prishtinë